

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetare, Xhevdet Abazi dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarit P.B. nga Prizreni, për shkak të veprave penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par. 1 të KPK-së, ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK-së, dhe falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur par.1 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Themelore – DKR në Prizren, dhe ankesës së të akuzuarit P.B., të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore – DKR në Prizren, P.nr.206/15, datë 07.12.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, me datë 15.09.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore DKR – në Prizren dhe të akuzuarit P.B., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prizren P.nr.206/2015, të datës 07.12.2016, përkitazi me veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par.1 të KPK-së, vërtetohet.

Me rastin e ankesave, sipas detyrës zyrtare, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prizren P.nr.206/2015, përkitazi me veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK-së, ashtu që REFUZOHET akuza kundër të akuzuarit P.B. për veprën penale, ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK-së, pasi që për veprën penale në fjalë ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Aktgjykimi i shkallës së parë, për veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur par.1 të KPK-së, pra, për pjesën refuzuese, mbetet i paprekur.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore – DKR në Prizren, P.nr.206/15, datë 07.12.2016, i akuzuari P.B., është shpallur fajtor për veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par. 1 të KPK-së, dhe për këtë vepër penale është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, dhe në të cilin do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga dt. 19.05.2011 e deri me dt. 11.07.2011.

I akuzuari është i obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 200 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Me aktgjykimin e ankimuar, bazuar në dispozitat e nenit 364 par. 1 nën par. 3 të KPK-së, i akuzuari P.B., është liruar nga akuza për vepër penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par. 1 të KPK-së, me arsyetim se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer edhe veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par. 1 të KPK-së.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

-Prokuroria Themelore – DKR në Prizren, për pjesën liruese, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, ndërsa, për pjesën dënuese, për shkak të vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari P.B. të shpallet fajtor edhe për vepër penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par. 1 të KPK-së, ndërsa për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim, se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

- I akuzuari P.B., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që i akuzuari të lirohet nga akuza e prokurorisë.

-Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën njoftoi Prokurorinë e Apelit, të dëmtuarin, të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij. Në seancën e kolegjit ishin të pranishëm i akuzuari P.B., i cili pasi më parë sqaroi disa nga pretendimet ankimore, ngeli në tërësi pranë propozimeve si në ankesë. Në seancën e kolegjit nuk prezantoi Prokurori i Apelit, e as mbrojtësi i të akuzuarit, edhe pse ishin të njoftuar në mënyrë të rregullt.

-Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën PPA/I.nr.80/17, të dt. 15.02.2017, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore – DKR në Prizren, të aprovohet si e bazuar, ndërsa ankesa e të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje penale – juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa, gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore – DKR në Prizren, dhe ajo e mbrojtësit të akuzuarit nuk janë të bazuara.

Pretendimet ankimore përkritazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës.

Në ankesën e të akuzuarit P.B., përkitazi me bazën ankimore shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pretendohet se dispozitivi i aktgjykimit është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, me arsyetim se aktgjykimi nuk ka mbështetje në provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ngase, asnjëri nga dëshmitarët në të cilët bazohet aktgjykimi i ankimuar nuk janë dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor, pastaj, me asnjë provë në shkresa të lëndës, duke përfshirë edhe deklaratat e dëshmitarëve N.M., M.TH., G.Th., T.C. dhe M.B., nuk vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprat penale që i vihen në barrë me aktakuzën e prokurorisë. Më tutje, në ankesë, pretendohet se deklaratat e dëshmitarëve në fjalë, pra, të cekur më lartë, janë deklarata që janë marrë pa prezencën e avokatit – mbrojtësit të akuzuarit, pra, është fjala për deklarata të marra në polici dhe prokurori, po ashtu, gjithherë sipas pretendimeve ankimore të akuzuarit, edhe procesverbalet e transkripteve të telefonatave janë prova të papranueshme, ngase, nga telefonatat në fjalë, nuk ka arritur as prokuroria e as gjykata të vërtetojë se kush janë personat në fjalë, që kanë folur me të akuzuarin në biseda telefonike, që do të thotë se ka mundësi që biseda në fjalët të jenë biseda të kurdisura telefonike dhe përfundimisht, që është më e rëndësishmja, gjykata e shkallës së parë, nuk ka arritur të vërtetojë fakte dhe rrethana edhe që kanë të bëjnë me statusin e të akuzuarit në vendin ku ka punuar deri në ditën kritike, duke potencuar kështu se i njëjti nuk e ka pasur statusin e personit zyrtar, për çka edhe pretendohet se i njëjti nuk ka mundur të shpallet fajtor për veprë penale marrja e rryshfetit nga neni 343 par. 1 të KPRK-së, duke konsideruar kështu, se me këtë gjykata e shkallës së parë ka bërë edhe shkelje të ligjit penal, kuptohet në dëm të akuzuarit, kur të njëjtin e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të cekura si më lartë nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë e as shkelje tjera të cilat kjo gjykatë i shqyrton edhe sipas detyrës zyrtare, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit.

Kështu, në këtë çështje penale-juridike, së pari dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, konkret, i njëjti nuk përmban kundërthënie me vetveten, e as me arsyetimin e tij, po ashtu, i njëjti në përshkrimin faktik të veprës penale përmban të gjitha elementet objektive dhe subjektive të cilat përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën i akuzuari edhe është shpallur fajtor, duke përfshirë këtu edhe veprimet inkriminuese që kanë të bëjnë me cilësinë e personit zyrtar për të akuzuarin. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe juridike, duke shpjeguar qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsyerash i merr si të provuara ose të pa provuara, duke bërë kështu, vlerësimin e provave kontradiktore konform dispozitave të nenit 370 par.7 të KPPK. Gjykata e shkallës së parë, ka bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i paraqitur lidhur me këto përfundime e veta, të cilat si të drejta e të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Arsyet të cilat i ka dhënë gjykata e shkallës së parë, kanë mbështetje në provat e procedura në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe atë sidomos në deklaratat e të dëmtuarve – dëshmitarëve N.M., M.TH., G.Th., T.C. dhe M.B., të cilët, përveç që vërtetojnë faktet dhe rrethanat se kanë biseduar me të akuzuarin personalisht, për mënyrën e marrjes së patentë shoferit, vërtetojnë edhe faktet dhe rrethanat për mënyrën e dhënies së parave për një gjë të tillë, të cilët po ashtu, kanë vërtetuar edhe identitetin e të akuzuarit P.B., pasi që kanë biseduar personalisht me të akuzuarin, duke mohuar kështu pretendimet e të akuzuarit se personat në fjalë nuk i njeh fare. Pastaj, përkitazi me statusin e personit zyrtar të akuzuarit, po ashtu, gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme, duke vërtetuar se i akuzuari përveç që ka qenë i punësuar në auto shkollën “Geni”, si person zyrtar i autorizuar për përgatitjen e kandidatëve për provim, dhe atë për pjesën praktike dhe teorike, i njëjti ka

qenë i autorizuar edhe për mbajtjen e ligjëratave si ato teorike dhe praktike, që do të thotë se në bazë të autorizimeve që ka ushtruar i akuzuari, ka marrë pjesë drejtë për së drejti edhe në komisionin e caktuar nga Ministria përkatëse e Qeverisë së Kosovës, për dhënien e patentë shoferëve, që do të thotë se i njëjti ka pasur cilësinë e personit zyrtar, prandaj, edhe në këtë drejtim plotësohen të gjitha elementet e veprës penale që kërkohet me dispozitat e nenit 343 par. 1 të KPK-së. Po ashtu, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e ankimuar e ka bazuar në prova që nuk janë proceduar fare në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ngase të gjitha deklaratat e dëshmitarëve, në të cilat deklarata edhe është bazuar aktgjykimi i ankimuar janë proceduar në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjë që vërtetohet nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor në shkresat e lëndës. Po ashtu, gjykata ka dhënë vlerësimin e saj edhe për faktet kundërthënëse, sidomos ka marrë parasysh edhe mbrojtjen e të akuzuarit, se dëshmitarët –

të dëmtuarit në fjalë as që i ka njohur ndonjëherë, ndërsa, shumat e të hollave që janë cekur në përgjimet telefonike janë shuma që janë paguar nga të dëmtuarit për pjesën teorike dhe praktike të provimit për patentë shofer, por një pretendim të tillë nuk e ka aprovuar duke u bazuar në deklaratat e dëshmitarëve, kuptohet përkitazi me identifikimin e të akuzuarit nga dëshmitari, ndërsa, përkitazi me arsyerat e marrjes së parave nga të dëmtuarit, edhe nga provat materiale materiale-përgjime telefonike, ku në detaje gjatë bisedave në fjalë vërtetohen faktet dhe rrethanat se i akuzuari iu ka marrë parat të dëmtuarve, duke iu premtuar se do t'i kalojë në provimin për patentë shofer, si për pjesën teorike dhe praktike, për çka më në detaje do të flitet gjatë elaborimit të gjendjes faktike në këtë çështje penale, prandaj aktgjykimi i ankimuar për veç që nuk përmban shkelje esenciale të pretenduara me ankesë, i njëjti nuk përmban as shkelje tjera esenciale që do të kushtëzonin anulimin e aktgjykimit të shkallës së parë.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe gjetjet e gjykatës.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, me ankesa, në esencë kontestohet vetëm mënyra e vlerësimit të provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë si dhe konkludimet të cilat ajo i ka nxjerrë të bazë të provave të proceduara. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, prandaj edhe përfundimet kanë pasuar të gabuara, pa mbështetje në prova. Kështu, sipas pretendimeve të akuzuarit, pretendohet se i akuzuari nuk i ka marrë paratë që të dëmtuarit t'i mundësohet marrja e lejes për patentë shofer, ngase, një gjë të tillë nuk ka mundur ta bëjë i akuzuari pasi që nuk është person zyrtar, por paratë i ka marrë në emër të shpenzimeve për marrjen e patentë shoferit, për çka edhe i akuzuari konsideron se gjykata e shkallës së parë, ka bërë edhe shkelje të ligjit penal, kur të akuzuarin e ka shpallë fajtor për vepër penale marrja e rryshfetit nga neni 343 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë, ngase, sipas provave dhe shkresave të lëndës si dhe gjendjes faktike të vërtetuar nga dëshmitarët por edhe procesverbalet e transkripteve të përgjimeve telefonike, rezulton se drejtë dhe në mënyrë objektive janë vërtetuar faktet dhe rrethanat, përkitazi me marrjen e parave nga të dëmtuarit, fakte këto dhe rrethana që nuk i konteston as vetë i akuzuari në mbrojtjen e tij, por me arsyetim sikur që deklaroi i akuzuari se paratë që cekën në përgjime telefonike kanë të bëjnë me shpenzimet për pjesën teorike dhe praktike të provimit për patentë shofer, e jo se i akuzuari i ka marrë për t'i kaluar në provimin për patentë shofer.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore edhe në këtë drejtim nuk qëndrojnë, ngase, nga vetë deklaratat e dëshmitarëve si; dëshmitarit N.M., vërtetohet se dëshmitari ka bashkëpunuar me të akuzuarin P.B., dhe se i kujtohet kur i dëmtuari V.V., i ka kërkuar ndihmë që të shkojë në auto shkollën e të akuzuarit i cili, për këtë i ka kërkuar para në shuma të caktuara, sikur që njëjtë ka vepruar edhe me të dëmtuarin F.G., i cili po ashtu ka dhënë shumë të caktuar të hollave dhe pastaj e ka kaluar provimin. Faktet dhe rrethanat në fjalë, po ashtu, i vërteton edhe dëshmitarit tjetër G.Th., i cili deklaron se për dhënien e provimit për patentë shofer për djalin e tij ka dhënë shumën e të hollave prej 500 €, fakte këto dhe rrethana të cilat i ka vërtetuar edhe dëshmitari tjetër M.Th. – djali i dëshmitarit G.Th.. Përveç deklaratave të dëshmitarëve gjykata e shkallës së parë, faktet dhe rrethanave në fjalë i ka vërtetuar edhe përmes përgjimeve telefonike ku nga bisedat telefonike vërtetohet se i akuzuari ka folur disa herë me të dëmtuarit e ndryshëm dhe nga të njëjtit ka kërkuar shuma të ndryshme të parave, duke filluar nga 250 €, - 350 € e herë here edhe 500 € dhe atë varësisht se a është bërë fjalë për pjesën teorike apo edhe praktike të patentë shoferit, fakte këto dhe rrethana që gjejnë mbështetje edhe në foto dokumentacionin por edhe vërtetimin për konfiskim të dokumenteve nga i akuzuari, ku vërtetohet se tek i akuzuari janë gjetur dokumente të ndryshme të dëmtuarve – formular të ndryshëm për aplikim për patentë shofer, e të përshkruara më detajisht si në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, në bazë të një gjendje të tillë faktike të vërtetuar si më lartë, e që më detajisht është elaboruar edhe në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë, rezulton se në veprimet inkriminuese të akuzuarit P.B., përmbushen të gjitha elementet e veprës penale marrja e rryshfetit nga neni 343 par. 1 të KPK-së, për çka, po ashtu, nuk qëndron pretendimi ankimor as për shkelje të ligjit penal, sikur që pretendohet në ankesën e të akuzuarit.

Pretendimet ankimore përkitazi me sanksionin penale dhe gjetjet e gjykatës.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore, përkitazi në këtë bazë ankimore nuk qëndrojnë. Me ankesën e Prokurorisë Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prizren, theksohet se gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim jo në përputhshmëri me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit dhe me një dënim të tillë nuk do të arrihet qëllimi i dënimit, me arsyetim se gjykata e shkallës së parë, edhe pse i ka numëruar disa nga rrethanat rendues, të njëjtat nuk i ka marr fare parasysh, kur të akuzuarit i ka shqiptuar dënim shumë të ulët me burgim. Ndërsa, në ankesën e të akuzuarit P.B., përkitazi me vendimin për dënim nuk theksohet asgjë shprehimisht, me arsyetim se pasi që aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal, atëherë edhe vendimi për dënim konsiderohet të jetë i kundërligjshëm, për çka, përkitazi me rrethanat lehtësuese dhe rënduese nuk thuhet asgjë shprehimisht.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit dhe atë konform dispozitave të nenit 73 të KPK. Pretendimet e Prokurorisë Themelore DKR në Prizren, nuk janë të bazuara, ngase në ankesë edhe pse cekën disa nga rrethanat konkrete rënduese të njëjtat i ka pasur, parasysh edhe gjykata e shkallës së parë, ndërsa nga ana e të akuzuarit në ankesë përkitazi me rrethanat lehtësuese dhe rënduese nuk thuhet asgjë shprehimisht.

Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e konstatuara në aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret, e sidomos faktin se i akuzuari është baba i 4 fëmijëve, por edhe kohën e kaluar nga kryerja e veprës penale deri më sot, rezulton se dënimi të cilin i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit është i drejtë dhe i ligjshëm, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit e po ashtu edhe në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPK-së.

Me rastin e ankesave të paraqitura kundër aktgjykimit të shkallës së parë, Gjkata e Apelit, duke vepruar sipas detyrës zyrtare e refuzoi akuzën kundër të akuzuarit P.B., për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK-së, pasi që për veprën penale në fjalë, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, ngase, duke pasur parasysh kohën e kryerjes së veprës penale, pra, më datën shkurt-prill të vitit 2011, atëherë, në muajin prill të vitit 2017, janë bërë plotë 6 (gjashtë) vite, nga kryerja e veprës penale, që do të thotë se ka arritur parashkrimi absolut i veprës penale, prandaj, bazuar në dispozitat e nenit 363 par. 1 nën par. 3 të KPPK-së, përkitazi me këtë veprë penale e ndryshoi aktgjykimin e ankimuar dhe e refuzoi ankesën e prokurorisë kundër të akuzuarit P.B..

Nga çka u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.70/2017, me dt. 15.09.2017

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Anëtarët e kolegjit,
1.Xhevdet Abazi

Kryetare e kolegjit,
Tonka Berishaj

2. Abdullah Ahmeti